

BULETIN JAVOR

24-28 KORRIK 2023



Shprehja

"Privatësia nuk është një opsion dhe nuk duhet të jetë çmimi që paguhet vetëm për të naviguar në internet."

Gary Kovacs

e javës

Përmbajtja:

- Vulnerabiliteti OpenSSH ekspozon sistemet Linux ndaj sulmeve kibernetike
- Mbi gjysmë milioni pajisje MikroTik RouterOS në rrezik nga sulmet kibernetike
- Shqipëria mbështet miratimin e Progres Raportit Vjetor të OEWG në OKB
- Microsoft - Patching Alert

Vulnerabiliteti OpenSSH ekspozon sistemet Linux ndaj sulmeve kibernetike

Vulnerabiliteti i OpenSSH i identifikuar si CVE-2023-38408 (CVSS: N/A) prek të gjitha versionet e OpenSSH para 9.3p2 dhe mund të shfrytëzohet për të ekzekutuar kode dashakeqe në distancë në hostet e kompromentuara.

Shfrytëzimi i suksesshëm i këtij vulnerabiliteti kërkon praninë e disa librave në sistemin e viktimës dhe që agjenti i autentifikimit SSH të ridrejtohet në një sistem të kontrolluar nga sulmuesi.

Për t'u mbrojtur nga kërcënimet e mundshme kibernetike, rekomandohet që përdoruesit të përditësojnë OpenSSH në versionin më të fundit.

[Link: Lexo më shumë](#)

Mbi gjysmë milioni pajisje MikroTik RouterOS në rrezik nga sulmet kibernetike

Vulnerabiliteti i identifikuar me CVE-2023-30799 (CVSS: 9.1), vlerësohet se ekspozon ndaj rreziqeve kibernetike rreth 500,000 - 900,000 pajisje RouterOS, përmes ndërfaqeve të tyre të internetit dhe/ose Winbox. mund të përdoret nga sulmuesit për të ekzekutuar kode arbitrarë në distancë dhe për të marrë kontrollin e pajisjeve të cenueshme.

Kundërmasat rekomandohen të jenë heqja e ndërfaqeve administrative të MikroTik nga interneti, kufizimi i adresave IP nga të cilat administratorët mund të autentifikohen, çaktivizimi i ndërfaqeve Winbox dhe ueb-it dhe konfigurimi i SSH për të përdorur çelësat publik/privat

[Link: Lexo më shumë](#)



Shqipëria mbështet miratimin e Progres Raportit Vjetor të OEWG në OKB

Sesioni i pestë i "Open-Ended Working Group (OEWG) On security of and in the use of information and communications technologies" zhvilloi punimet e tij në datat 24-28 korrik 2023 dhe konkludoi me miratimin e Progres Raportit Vjetor. Progres Raporti përfaqëson një udhëzim të punës së ardhshme të OEWG dhe reflekton mbi peizazhin dinamik të kërcënimeve në ekosistemin kibernetik.

Shqipëria, përfaqësuar me Misionin e Përhershëm pranë OKB dhe Drejtorin e AKCESK Znj. Edlira Gjollëshi, pas kontributit në hartimin e Programme of Action dhe rolin aktiv në sesionin e katërt të OEWG të zhvilluar në 6-10 Mars, mbështetën miratimin e Progres Raportit Vjetor, duke e konsideruar si një mjet të nevojshëm për punën e ardhshme të OEWG.

Progres raporti propozon hapa konkretë për të avancuar paqen dhe sigurinë në hapësirën kibernetike, duke reflektuar zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë kibernetike në kontekstin e sigurisë ndërkombëtare.

AKCESK, në cilësinë e autoritetit përgjegjës të fushës së sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, vijon të ndjekë diskutimet ndërkombëtare të fushës, në koordinim të plotë me strukturat e ministries së linjës dhe misionin e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë.

Microsoft - Patching Alert

Publikimi i ri i përditësimeve të sigurisë së Microsoft adreson 132 dobësi sigurie në produkte, nga të cilat 6 vulnerabiliteti të tipit zero-day.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit të instalojnë përditësimet e nevojshme.

[Link: Lexo më shumë](#)